



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PRESEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" pn.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	18.08.2025
NR/BR.	01.31525
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës z. Xhavit ZARIQI
NGA/OD/FROM	Kryetari i Komunës Agim ALIU
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për Subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 40, paragrafi 40.2, e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr, 28/04 qershor 2008) Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 25 paragrafi 2, pika 2.9, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 dt. 28.06.2013, si dhe Ligjit Nr. 04/L-179 për Transport Publik, Kryetari i Komunës e bënë këtë:

PROPOZIM - VENDIM

(Për Subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik)

Ky propozim Vendim ka për qëllim të përcaktoj kushtet dhe procedurat e subvencionimit të transportit urban dhe urbano-periferik :

1. Transporti urban dhe urban-periferik do të subvencionohet nga Komuna e Ferizajt në euro për kilometër (€/km), të cilat do të llogariten në bazë të rendeve të udhëtimit të cilat janë të vërtetuara nga organi kompetent.
2. Subvencionimi bëhet në vlerë prej € për kilometër (€/km), ku tarifa për transportin urban është 0.60 €/km, ndërsa për transportin urban-periferik është 0.40 €/km. Ky subvencion është i planifikuar të zbatohet për një periudhë pesë vjeçare me mundësi vazhdimi.
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë emëron një komision për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të arritura në departamentin e transportit pas thirrjes publike për subvencionimin e transportit urban dhe urban-periferik.
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ka përcaktuar që në kuadër të programit të subvencionimit të përfitojnë disa kategori të caktuara për bileta ditore dhe mujore. Këto kategori përfshijnë: nxënësit, studentët, pensionistët, personat e dalë nga lufta, si dhe personat me nevoja të veçanta.

A r s y e t i m

Subvencionimi i transportit publik të udhëtarëve, në veçanti në zonat urbane dhe ato urban-periferike, ka për qëllim përmirësimin e kushteve të transportit publik duke ofruar shërbime më të sigurta, më efikase dhe më të aksesueshme për qytetarët. Ky subvencionim synon të lehtësojë qasjen më të mirë në transport për kategoritë më të ndjeshme sociale dhe për të rritur përdorimin e transportit publik, duke ulur kështu edhe ndotjen mjedisore dhe dendësinë e trafikut në zonën qytetit të Ferizajt.

Mënyra e subvencionimit:

Subvencionet i jepen direkt operatorëve të transportit për linjat e transportit urban dhe urban-periferik. Kështu, operatorët mbështeten financiarisht për të ofruar bileta me çmime të reduktuara apo falas për kategoritë e caktuara.

Subvencionimi i transportit të udhëtarëve urban dhe urban-periferik është domosdoshmëri për të garantuar ofrimin e shërbimeve efikase, të sigurta dhe të përballueshme për qytetarët. Kjo masë e subvencionimit ka për qëllim dhe synon jo vetëm përmirësimin e kushteve të transportit, por edhe mbështetjen sociale për kategori të caktuara të qytetarve në tërësi.

1. Pensionistet, kategoritë e dala nga Lufta dhe personat me aftësi të veçanta përfitojnë biletat falas në të gjitha linjat e transportit urban dhe urban periferik
2. Nxënsit e Shkollave të Mesme të Ulëta përfitojnë nga subvencionimi në bileta ditore dhe mujore 50 % në transportin urban – periferik, ndërsa transportin urban bileta ditore dhe mujore do të jetë falas.
3. Studentët përfitojnë subvencionim prej 50 % në bileta ditore dhe mujore vetëm në transportin urban-periferik.

Përmes subvencionimit të transportit urban dhe urban-periferik sigurohet:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në transport të udhëtarëve – Investimet në transportin publik mundësojnë që operatorët e transportit të kësaj fushe të investojnë në mjetet e tyre për të ofruar shërbime sa më të mira dhe të qëndrueshme, duke ndikuar edhe në mbrojtjen e mjedisit.
- Lehtësimi i ngarkesës ekonomike për qytetarët – Çmimet e reduktuara për biletat ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kostos së jetesës për shumë familje, veçanërisht në kohë sfida ekonomike.
- Zhvillimi i qëndrueshëm urban – Inkurajimi i përdorimit të transportit publik ndihmon në uljen e përdorimit të veturave private, çka ndikon në zvogëlimin e ndotjes së ajrit, bllokimeve në trafik dhe konsumit të energjisë.

Për të arritur këto objektiva, Komuna Ferizajt konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë e konsideron të arsyeshme dhe në interes të përgjithshëm publik ndarjen e fondeve për subvencionimin e transportit publik, si pjesë e angazhimit për një qytet më të qasshëm, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e saj.

Andaj kërkoj nga Kuvendi si i tillë të miratohet ky Propozim -Vendim.